

Njoftim për përqendrim me të cilin Zavarovalnica Triglav d.d. Lubjanë, Slloveni dhe ASEF Holdco SARL Senningerberg, Luksemburg do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi Arsano Medical Group d.o.o Zagreb, Kroaci

(lënda nr. 08-120/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 30.07.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi për përqendrim me të cilin **Zavarovalnica Triglav d.d.** me seli të regjistruar në Mikloshiçeva cesta 19, SI-1000 Lubjanë, Slloveni dhe **ASEF Holdco SARL** me seli të regjistruar në Rue Lou Hemmer 8, 1748 Senningerberg, Luksemburg, do të fitojnë kontrollin e përbashkët mbi **Arsano Medical Group d.o.o.** me seli të regjistruar në Ilica 1A, 10000 Zagreb, Kroaci.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

Zavarovalnica Triglav d.d. është shoqëria mëmë e Grupit Triglav, i cili përbëhet nga 12 kompani sigurimesh në Slloveni dhe Evropën Juglindore. Aktivitetet kryesore të grupit janë ofrimi i shërbimeve të sigurimit, sigurimit të jetës dhe jo-jetës (sigurimi nga aksidentet, sigurimi shëndetësor dhe lloje të tjera sigurimesh) dhe risigurimit.

Triglav ofron shërbime në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të saj të varura: Triglav Osiguruvanje SHA (Bul. 3-ta Makedonska brigada nr. 36, 1000 Shkup); Triglav Osiguruvanje Život SHA (Bul. 3-ta Makedonska brigada nr. 36, 1000 Shkup); Shoqëria Pensionale Triglav SHA (Bulevardi 8 Shtatori nr. 18, kati 2, 1000 Shkup) dhe Triglav, menaxhimi i patundshmërive SHPKNJP Shkup (Dame Gruev 8/5, 1000 Shkup).

ASEF Holdco SARL është një kompani holding e themeluar në Luksemburg, e cila shërben si një instrument investimi i fondit të kapitalit privat Adriatic Structured Equity Fund ASEF SCSp ("**Fondi PCP I**"), i cili këshillohet nga Provectus Capital Partners d.o.o. ("**PCP**"). **PCP** është një kompani e pavarur udhëheqëse investimesh në Evropën Juglindore, e themeluar në vitin 2018. PCP këshillon dy fonde të kapitalit privat me seli në Luksemburg – fondin e parë Fondi PCP I i vitit 2020 dhe fondin e dytë PCP SEE Fund II SCSp ("**Fondi PCP II**") i vitit 2025, të cilat investojnë në pjesë shumicë të kompanive në mbarë rajonin. Investimet e të dy fondeve që këshillon PCP bazohen në partneritete të forta me udhëheqësin dhe pronarët, si dhe në zbatimin e standardeve më të mira të qeverisjes së korporatave. Të dy fondet e kapitalit privat të këshilluara nga PCP kanë mbledhur mbi 260 milionë euro nga investitorët institucionalë (BERZH, FIE, fonde pensionesh, kompani sigurimesh, banka, etj.) dhe kanë investuar në 8 platforma në Kroaci, Slloveni dhe Rumani, dhe së bashku kanë afërsisht 1,900 të punësuar.

Grupi i PCP-së, duke përfshirë edhe kompanitë e tij të portofolit të kontrolluara, nuk ka subjekte të regjistruara ose aktivitete në Maqedoninë e Veriut.

Arsano Medical Group d.o.o. është një kompani holding e një grupi aktiv në fushën e shërbimeve shëndetësore private. Rrjeti i AMG-së përbëhet nga spitale speciale, poliklinika dhe institucione të tjera shëndetësore në Kroaci dhe ofron një spektër të gjerë të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë shërbimet parandaluese, specialistike-konsultative,

diagnostikuese, kirurgjikale, rehabilituese dhe shërbime të tjera shëndetësore. Arsano Medical Group d.o.o. përbëhet nga shoqëritë e mëposhtme, të gjitha me seli në Kroaci: *Arsano Medical d.o.o., Arsano Medical Group d.o.o., Neomedic d.o.o., Specijalna bolnica dr. Nemec (Spitali Special dr. Nemec), Arithera d.o.o., Specijalna bolnica Arithera (Spitali Special Arithera), Orto-Artro d.o.o., Arsano Adria d.o.o., ASEF Aviva d.o.o., Poliklinika Aviva, Poliklinika Uro centar, Ustanova Prima Nova, J.D.D. Resono d.o.o., Poliklinika za radiologiju i neurologiju Dijagnostika 2000 (Poliklinika për Radiologji dhe Neurologji Diagnostika 2000), Arsano Oftalmo d.o.o. dhe Poliklinika Ritz Nova.*

Arsano Medical Group d.o.o. nuk ka shoqëri të varura, filiale ose zyra përfaqësuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon asnjë lloj qarkullimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

31.07.2026

Shkup